



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:136710

Datë: 27.02.2023

Numri i dokumentit: 04017535

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.204/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, (në objektin e Gjykatës në Mitrovicë-Veri) kryetari i trupit gjykues –gjyqtari Avni Mehmeti, me anëtarët e trupit gjykues – gjyqtarët; Gëzim Ademi dhe Rrahman Beqiri, me procesmbajtësen Edita Kelmendi. Në çështjen penale kundër të pandehurit A.J, i akuzuar për veprat penale; Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tej KPRK) dhe veprën penale; Mbajtje në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.262/2022 të dt.19.08.2022. Pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, më dt.20.02.2023 në prezencën e palëve; Prokurores së shtetit në PTH në Mitrovicë, Fetije Bajrami, të pandehurit A.J, mbrojtësit të tij, av.Shyqyri Sylja dhe të dëmtuarit D.B, ku seanca e shqyrtimit gjyqësor është regjistruar në procesverbal dhe ka qenë e hapur për publikun. Më datën 20.02.2023 ka përfunduar shqyrtimi gjyqësor, më dt.21.02.2023 është shpall publikisht aktgjykimi, ndërsa më datën 27.02.2023 është përpiluar me shkrim ky;

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit;

A.J nga i ati, e ëma, e gjinisë, i lindur më në fsh. P....., komuna e S....., ku edhe tani jeton, me numër personal të ID:, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i 2 (dy) fëmijëve, bujk, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme – gjimnazin, i gjendjes së dobët ekonomike, ndaj tij zhvillohen edhe procedura tjera penal, i cili;

I.

SHPALLET FAJTOR

SEPSE:

Më dt.04.07.2022 rreth orës 01:25 minuta, në fsh.P....., komuna e S..... në udhëkryqin që lidh dy rrugët; “.....” dhe “.....” me dashje ka tentuar që ta privoj nga jeta personin tjetër,

ashtu që pas një mosmarrëveshje në mes vëllait të pandehurit, B.J me axhën e tij H.J, rreth pronësisë së një garazhe, i pandehuri A.J ka tentuar që ta privoj nga jeta të dëmtuarin D.B, duke menduar së është axha i tij H.J. Natën kritike, i dëmtuari D.B ka shkuar në fsh.P....., në shtëpinë e H.J, me qëllim që t'ia dërgoj 50€ bashkëshortes së H....., i cili ka qenë në ndalim policor në Stacionin policor në S..... Pastaj, i dëmtuari D.B me automjetin e tij të markës “Mercedes” ngjyrë hiri, me targa, duke u kthyer nga fshati Prekaz dhe derisa ishte në lëvizje në lagjen “.....”, i pandehuri e vëren automjetin dhe duke menduar se në atë automjetin është axha i tij H.J, me dashje e ndërmerr veprimin ashtu që me armë të zjarrit modeli M57 e kalibrit 7.62mm, shtijën 8 (tetë) herë në drejtim të automjetin “Mercedes” dhe katër predha e godasin automjetin në pjesën e pasme, duke rrezikuar kështu drejtpërdrejt jetën e të dëmtuarit D.B. Pas kësaj, i dëmtuari me shpejtësi largohet nga vendi i ngjarjes dhe menjëherë e lajmëron rastin në polici. Në vendin e ngjarjes, policia gjen 8 (tetë) gëzhoja dhe armën e gjejnë te i pandehuri të cilën edhe e sekuestrojnë. Ndërsa, pas sigurimit të ekspertizës balistike është vërtetuar se gëzhojat që janë gjet në vendin e ngjarjes, janë shkrepur prej armës që është sekuestruar nga i pandehuri.

- Me këtë ka kryer veprën penale; Vrasje në tentativë nga neni 172 e lidhur me nenin 28 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

II. SHPALLET FAJTOR

SEPSE:

Prej datës se pacaktuar e gjer më dt.04.07.2022 pa leje përkatëse ka mbajtur në posedim dhe pronësi një armë në kundërshtim me Ligjin për armët 05/L-22 në Republikën e Kosovës, armën e kalibrit 7.62 mm, M 57 me numër serik; dhe një karikator të cilat pastaj i ka sekuestruar policia e Kosovës.

- Me këtë ka kryer veprën penale; Mbajtje në pronësi, në kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata në mbështetje të 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 28, 38, 39, 42, 69, 70, 71, 72, 76, 79, 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe 366 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPP-së, të pandehurin A.J, e:

GJYKON

- Për veprën penale; Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, pika I. e akuzës, i cakton;

1. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite.

- Për veprën penale; Mbajtje në pronësi, në kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, pika II. e akuzës, i cakton;

2. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.

Gjykata në mbështetje të nenit 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të pandehurit A.B, i;

SH Q I P T O N

- I. DËNIM UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje 3 (tri) vjet e 4 (katër) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në këtë dënim të shqiptuar të pandehurit i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data nga dt.04.07.2022 deri më 23.12.2022 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt.23.12.2022 deri më 03.02.2023.
- II. OBLIGOHET i pandehuri A.J që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 100 (njëqind) euro dhe shumë prej 50€ (pesëdhjetë) taksë për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Të gjitha obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditë pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.
- III. Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 e 2 të KPP-së, si dhe nenit 366 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, URDHËRON konfiskimin të përhershëm të sendeve si në vijim:
Armën e kalibrit 7.62mm M57 me numër serik dhe një karikator me dy fishek. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, arma, karikatorit dhe municion duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, pasi të vërtetohet se arma në fjalë nuk është përdorur në ndonjë rast tjetër që ende është i hapur.
- IV. Pala e dëmtuar, ka heq dorë nga kërkesa për kompensimin e dëmit.

ARSYETIM

- Aktakuza;

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr..... të dt.19.08.2022 kundër të pandehurit A.J për veprat penale; Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprën penale; Mbajtje në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

- Kompetenca:

Sipas nenit 1, paragrafi 1, të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për t'i gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Sipas nenit neni 9, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 i këtij Ligji thekson se Gjykata Themelore e Mitrovicës, me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë.

Bazuar në aktakuzën e ngritur, vepra e pretenduar penale ka ndodhur në dhe rrjedhimisht, bie brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës. Sipas nenit 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-ës, veprat penale vrasje në tentativë hynë në kompetencë lëndore të Departamentit për Krime të Rënda.

- Rrjedha e procedurës penale;

Më 12 shtator 2022 Gjykata për këtë lëndë penale e ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Seanca është mbajtur në prezencën e palëve; Prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Fetije Bjarami, të pandehurit A.J dhe mbrojtësit të tij, av.Muharrem Prekazi. I pandehuri është deklaruar se e pranon fajësinë lidhur me veprën penale si nën pikën II të aktakuzës për veprën penale; Mbajtje në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga nenin 366 par.1 të KPRK-së, ndërsa e ka mohuar fajësinë për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë se deklaruar nga i pandehuri për pikën II të aktakuzës, duke vlerësuar se janë përmbushur të gjitha kushte ligjore që kërkohen sipas nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale.

Më 20 shtator 2022 mbrojtësi i të pandehurit A.J, av.Muharrem Prekazi, brenda afatit ligjore ka parashtruar kundërshtim në provat në aktakuzë dhe kërkesë për hedhjen e aktakuzës.

Më 29 shtator 2020 Gjykata ka vendosur lidhur me kundërshtimet e parashtruara nga mbrojtësi i të pandehurit, av.Muharrem Prekazi. Gjykata e ka refuzuar në tërësi kundërshtimin dhe ka konfirmuar aktakuzën e prokurorisë në raporte me të pandehurin për veprën penale; Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Më 4 tetor 2022 mbrojtësi i të pandehurit A.J, av.Muharrem Prekazi ka parashtruar ankesë kundër aktvendimit P.nr.204/2022 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Më 20 tetor 2022 Gjykata e Apelit e Kosovës, sipas aktvendimit PN.nr.1087/2022 ka refuzuar si të pabazuar kundërshtimet e mbrojtësit, si dhe ka vërtetuar aktvendimin P.nr.204/2022 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

- Shqyrtimi gjyqësor dhe publiciteti;

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në këto data;12.12.2022, 13.12.2022, 15.02.2023 dhe 20.02.2023. Të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor kanë qenë të hapura për publikun.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës; 20.02.2022 i pandehuri A.J në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale të cilat akuzohet; Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 sipas KPRK-së.

Prokurorja e rastit, Fetije Bajrami dhe mbrojtësi i të pandehurit A.J, av.Shyqri Sylja kanë propozuar të miratohet pranimi i fajësisë së deklaruar nga i pandehuri, duke vlerësuar se përmbushen të gjitha kushte ligjore sipas nenit 242 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i pandehuri A.J, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, dhe ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri. Gjykata, gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë; dëshmitë e dëshmitarëve; R.S, F.B, D.B, H.J dhe H.J, raporti i përpiluar nga zyrtari policor F.B i datës 04.07.2022, raporti informues i datës 04.07.2022, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve (armës) i datës 04.07.2022, raporti mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes, skica e vendit të ngjarjes, lista e dëshmive, raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë nr.AKF/..... të datës 10.08.2022, raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë AKF/..... e dt.12.12.2022, foto-dokumentacioni, dosja për të kaluarën kriminale në emër të pandehurit.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri në shqyrtimin fillestar dhe në shqyrtimin gjyqësor është bërë në mënyrë vullnetare, se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë. Gjykata ia kishte tërhequr vërejtjen të pandehurit se pas pranimin të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është

rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë.

Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata ka miratuar pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri A.J, pasi që paraprakisht është bindur se plotësohen të gjitha kushtet ligjore të kërkuara sipas nenit 242 paragrafi 2 nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPP, si në vijim, se, i;

- pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimit me mbrojtësin
- pranimi i fajit mbështete në faktet e akuzës, siç janë; dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat materiale apo fizike, që janë paraqitur nga prokurori i shtetit; dhe
- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

- Fjala përfundimtare;

Prokurorja në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Fetije Bajrami, në fjalën përfundimtare ka propozuar Gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit duke i marr parasysh rrethanat rëndësues dhe lehtësues.

Mbrojtësi i të pandehurit A.J, av.Shyqyri Sylja, në fjalën përfundimtare ka propozuar Gjykatës që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin t'i kenë parasysh rrethanat lehtësues, faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për dy veprat penale, është i martuar, prind i dy fëmijëve të vegjël, mbajtës i vetëm i familjes, se me të dëmtuarit është pajtuar, se të dëmtuarit nuk i janë bashkëngjitur ndjekjes penale dhe nuk kanë kërkuar kompensimin të dëmit, se i pandehuri është penduar thellësisht për këtë rast, i pandehuri nuk është person i dënuar më parë. Në fund, propozon që të pandehurit t'i shqiptohet ndonjë dënim më i butë sipas rrethanave që janë arsyetuar si më lartë, duke qenë i bindur se edhe me një dënim të ulët do të arrihet qëllimi i dënimit.

I pandehuri A.J në fjalën përfundimtare e ka përkrah fjalën përfundimtare që ka paraqitur avokati i tij dhe ka shtuar se i vjen keq dhe është penduar për rastin që ka ndodh duke premtuar se nuk do të përsërisë sjellje të ngjashme dhe do ta respekton rendin dhe ligjin.

Gjykata duke u mbështetur në pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe në bazë të provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimit ka vërtetuar se i pandehuri A.J është i përgjegjshëm dhe

përgjegjës (fajtor) për veprën penale për të cilën akuzohet; Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe veprën penale; Mbajtje në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

- Konfiskimi;

Gjykata në mbështetje të nenit 282 par.1 dhe 2 të KPP-ës dhe nenit 366 par.3 KPRK-ës, ndaj të pandehurit ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armës, karikatorit dhe municionit, siç përcaktohet me lartë në këtë aktgjykim.

Gjykata rikujton se i pandehuri nuk ka pas leje e as autorizim për posedimin apo përdorimin e armës. Se sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike nga këto arsye gjykata ka vendosur t'i konfiskoj përherë dhe të njëjtat ka urdhëruar që të shkatërrohet. Gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e përhershëm të armës sipas nenit 366 par.3 KPRK-ës, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm, konfiskimi ishte propozuar në aktakuzë – dispozita e lartcekur e këtij Kodi, përcakton shprehimisht konfiskimin e detyrueshëm të sendeve të tilla.

- Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit;

Gjykata lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar, dashjen direkte të tij te kjo vepër penale, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial në këtë vepër penale, motivin që e ka shtyre të pandehurin për të vepruar. Gjithashtu, mënyrën e kryerjes së veprës penale, se ka përdorur një armë zjarri dhe më të ka shtënë një numër të madhe plumbave në drejtim të të dëmtuarit, që tregon se ka shprehur shkallën e lartë të dashjes. Në raport me veprën penale armëmbajtje pa leje, është vlerësuar faktin se i pandehuri për një kohë të gjatë e ka mbajtur armën pa leje dhe se të njëjtën e ka përdorur siç përshkruhet në pikën I të aktakuzës. Gjithashtu si rrethana rënduese është vlerësuar edhe e kaluara e të pandehuri, që sipas të dhënave zyrtare të siguruar nga policia e Kosovës, rezulton se kundër tij zhvillohen procedura edhe për rastet tjera penale.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese është marr për bazë dhe vlerësuar fakti se i pandehur pas kësaj vepre penale ka treguar sjellje të mira, është pajtuar me axhën e tij, dhe me të dëmtuarin D.B, si

rezultat i pajtimit në mes palëve të dëmtuarit nuk i janë bashkangjitur ndjekjes penale kundër të pandehurit dhe s'kanë kërkuar kompensimin e dëmit. Gjithashtu, është vlerësuar fakti se i pandehuri është i moshës relativisht të re, se është prind i dy fëmijëve të vegjël, mbajtëse i vetëm i familjes, për këtë rast ka kërkuar falje të dëmtuarve, dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjelle të tilla dhe nuk do të veproj më në kundërshtim me ligjin. Si rrethanë shumë lehtësues është vlerësuar fakti se përkundër që në veprimet e të pandehurit janë konsumuar të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë, përkundër që ka shtijë me armë në drejtim të të dëmtuarit, fatmirësisht asnjë predhë nuk e ka godit të dëmtuarin dhe nuk është shkaktuar ndonjë pasojë, përveç dëmit material që është shkaktuar në automjet e tij. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese është vlerësuar pranimi i fajësisë nga i pandehuri në tërësi për veprat penale për të cilat akuzohet si dhe faktin se vepra penale ka mbetur në tentativë, këto dy rrethana janë marr për bazë nga Gjykata për zbutjen e jashtëzakonshëm të dënimit nën kufirin e paraparë ligjor në raport me veprën penal pika I, e duke u mbështetur në nenin 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.3 dhe në nenin 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të KPRK-ës.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si më lartë ndaj të pandehurit A.J, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale, moshën e të pandehurit dhe të gjitha rrethanave të tjera që kemi cekur është adekuat dhe jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat tjerë, që të në të ardhmen të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 të KPP-ës.

Nga ajo që u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.204/2022 të datës 27.02.2023

Procesmbajtësja:

Edita Kelmendi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Avni Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, llogaritur nga dita e pranimit me shkrim të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për palët gjykatën.